

Informacion mbi procedurat e vizave për shtetasit Shqiptarë

Kërkesa e vizës është e drejtë dhe detyrim i vet shtetasit, me përjashtim të rasteve kur ajo bëhet për interesa shtetërore, për punë apo raste humanitare.

Në këto raste kërkesa e vizës mbështetet edhe nga institucionet përkatëse.

Sqarohet se lëshimi i vizave të huaja për shtetasit shqiptarë është e drejtë ekskluzive e shtetit të huaj.

Konsullata pranë Ambasadës Shqiptare në Uashington nuk ka mundësi dhe nuk mund të rekomandojë dhënien e vizave në ShBA për çdo lloj arsyeje

Çfarë duhet të kenë parasysh shtetasit shqiptarë para se të udhëtojnë jashtë shtetit

a) Informacioni mbi vendin ku do të shkojnë

Shtetasit duhet të sigurohen nëse në vendet ku do të shkojnë, në momentin e udhëtimit, ka trazira politike, katastrofa, sëmundje dhe epidemi apo është e nevojshme të vaksinohen. Ata kanë nevojë të informohen edhe për traditat, zakonet, doket e vendeve ku do të shkojnë.

Për një informacion të tillë ata mund të interesohen paraprakisht pranë përfaqësive të huaja, për t'u informuar nëse duhet të kenë kujdes për ndryshime të sistemit të hyrjes, të respektimit të ligjeve të veçanta lokale. Një informacion i tillë mund të ofrohet edhe në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Është mirë që shtetasit të kenë me vete adresat e përfaqësive shqiptare që mbulojnë vendet ku do të kalojnë.

b) Dokumentacioni që duhet paraqitur paraprakisht në një përfaqësi të huaj

Dokumentacioni që duhet të sigurojnë shtetasit për të marrë vizë është i ndryshëm në funksion të legjislacionit të huaj dhe qëllimit të udhëtimit. Në përgjithësi shtetasit duhet të kenë pasaportë udhëtimi me vlefshmëri të mjaftueshme, të plotësojnë formularin e aplikimit, të paraqesin ftesën apo

garancinë nga pritësi në vendin e huaj si dhe sigurimin e udhëtimit/shëndetit për raste urgjence mjekësore dhe kthim në Atdhe.

Për dokumentacionin tjetër mbështetës informacionet do të merren rast pas rasti nga ambasadat e shteteve për ku do të udhëtohet.

Në faqet elektronike të ministrive apo vetë ambasadave, kur kanë, ofrohet zakonisht informacion për dokumentacionin e nevojshëm për vizat.

c) Vendet në të cilat kërkohet paraprakisht viza e hyrjes

Shtetet e huaja i trajtojnë kërkesat për viza të shtetasve shqiptarë në përfaqësitë e tyre si në tabelën më poshtë

Shtetet e Bashkuara [Ambasada Amerikane në Tirane](#)

Meksikë [Ambasada e Meksikës në Romë](#)

Panama [Ambasada e Panamasë në Romë](#)

Republika Domenikane Ambasada e Republikës Domenikane në Athinë, [Formulari](#)